



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. Serial 000089

LEJE
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR
Nr. 13 Prot., datë 04/04/2023

Miraturar me:
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR MAT

Nr.9, datë 28/03/2023

Emri i individit/subjektit: "A.N.K" SH.P.K
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): J92408001N
Baseni Ujor: MAT
Qarku: LEZHË
Bashkia/ Njësia administrative: LEZHË/SHËN KOLL
Koordinatat: X=472225.3; Y=4616985.7; Z=11 m.m.n.d
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: TEKNOLOGJIK
Prurja mesatare vjetore: 20 l/s
Prurja ekologjike nuk ka
Sasia e ujit që jepet për përdorim: 4 l/s
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka): nuk ka
Vendi ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer: nuk ka
Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Lumi Mat
Sipërfaqja e tokës, me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes): nuk ka
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): Sipas kushteve të Lejes dhe Vendimit bashkëngjitur
Periudha e vlefshmërisë: 5-VJET
Hyrja në fuqi: Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve

KRYETARI
GJERGJ PRENDI



Kushtet e posaçme të lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë, ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Në rastin e shfrytëzimit të burimit ujqor për hidroenergji, të instalojë një stacion hidrometrologjik, për matjen e prurjeve ditore, në një distancë jo më shumë se 150 m poshtë çdo veprë marrjeje dhe të dhënat t'i raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
7. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
8. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
9. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitarë të mbrojtjes.
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit.
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike, sipas specifikimeve në leje apo autorizim.
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor në rast të një aksidenti, apo incidenti.
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjendjen e mëparshme.
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur.
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.